

## Veset

1. Prej pikpamjes së shrkimtarit, fjala ‘ves’ mund të kuptohet si ‘tepri’—virtyti i tepruom bâhet ves. Të tilla janë:

- *Dialektizmat* e tepruome
- *Mbipërdorimi* i gjuhës figurative
- *Përdorimi i huazimeve* kur s’është nevoja.
- *Përsëritja* e panevojëshme ose e tepruome e fjalëve a kombinimeve tingullore
- *Shtimi ose mungimi* i tingujve a germave prej padijes; jo si zgjedhje artistike
- *Tepria në sinqeritet*, ose *kërkimi i faljes* sepse po shkruan sinqerisht.

2. Përdorimet pasuese janë vese që duhen shmangë.

- *Gabimet gramatikore* në shkrim a ligjrim
- *Moskonsistenca* e kohës së foljeve
- *Mospajtimi* i foljeve me kryefjalën ose me kohën e veprimt
- *Mospajtimi* i mbiemëniave me emënat që ata modifikojnë.
- Përdorimi i fjalëve a shprehjeve *vulgare*; direktisht ose indirektisht
- *Përdorimi i fjalëve në mënyrë të gabuome* ose në kontekste të gabuome
- *Përdorimi* i fjalëve të panevojëshme ose të tepruome
- Përdorimi i një *gjuhë të papërpunuome* ose përdorimi *joaftsor* i gjuhës figurative
- *Përdorimi i të njëjtës fjalë në kontekste* të ngjashme por me kuptime të ndryshëme; jo qëllimisht.
- *Përziemja e gjuhëve*, p.sh., përdorimi i fjalëve a shprehjeve të huaja pa i shjegua.
- *Shmangia e një teme* të vështirë duke kalua në një temë tjetër.
- *Thyemja* ose keqpërdorimi i shenjave të piksimit
- *Madhështia* personale, fisnore, krahinore, a kombëtare.

### Acrilogjia

Përdorimi i gabuom i fjalëve me tingëllimë të përafërt, por edhe i fjalëve të tjera. Ka kuptim të përafërt me malapropizmin – përdorimin e gabuom të një fjale.

*Ndërsa po vdiste, atij i doli para syve një aluzion burimi me ujë të freskët.*

Këtu, autori ka dashtë me shkrua ‘iluzion’; një imazh i krijuom prej mendjes.

### Akrioni

Përdorimi i një fjale që ka kuptim të kundërt me fjalën që autori cakon me përdorë; joqëllimisht

*Kurr s’do të kisha pasë uzdajë për një mjerim kaq të madh.*

Njeriu nuk shpreson për mjerim.

### Amfibologjia

Paqartsi sintaksore, e cila mund të rrjedhi prej keqpikimit.

*Kalo, shpejt në shtëpi shko.*

*Kalo shpejt, në shtëpi shko.*

Në varsi prej qëllimit të kumtit, njëna prej fjalive të masipërme është e gabuome.

### Askematistoni

Përdorim i një gjuhe të thjeshtë, por jo me qëllim modestie; autori nuk njih mjeshttrinë e stilit. Mund të përfshijë edhe përpjekje të padhunti me përdorë figurat letrare.

*Po kalonte një djalë i gjatë si shtyllë elektrike.*

### Barbarizmat

Në gjuhën shqipe, barbaizmat ndahen në tri kategori kryesore: *latinizmat*, të cilat mund të kenë edhe burime greke; *anglizmat*; dhe *otomanizmat* (fjalë me burime arabe, persiane, turke, dhe, indirektisht, greke a latine). Në varsi prej nevojave e nxitjeve, një autor mund të përdori secilën sosh. Për shembull, në varsi prej identitetit fetar, një person mund të përdori ‘lat. shpirt’ ose ‘arab. ymër’.

Ka njerëz që përdorin barbarizma edhe si aserta të njëfarë qytetnimi, p.sh., ‘uikend, show, ose best friend’. Barbarizmat u japin ligjratave e shkrimeve një laramanizëm vulgar. Autori tingllon veçsisht i paaftë kur ai ose ajo përdorë tri-katër gjuhë në një tekst të shkurtë, p.sh.

Laramanisht: *Meqë të gjith jemi bosh, hajde të kalojmë një uikend me mysafirin tim. Ju presim para sabatxhive.*

Shqip: *Meqë të gjith jemi të lirë, ej të kalojmë një fundjavë me miku tim. Ju presim para ordreqësve.*

Barbarizmat janë shmangie negative prej standardit a normës së një gjuhe. Por, ato nuk duhen ngatërrua me huazimet e nevojëshme, p.sh., ‘*film, email, kibernetikë*’, etj.

Barbarizmat mund të shmangen duke përdorë fjalorë etimologjikë (Çabej, Topalli) ose duke i zëvendësua ato me fjalë prej fjalorëve të Gazullit, Panos, Demës, etj.

### Hipalazhi

Ndërrimi i rendit të fjalëve në një shprehje, klauz, a fjali në një mënyrë që nuk tingëllon natyrëshëm, tipike e njerëzve që janë duke mësua shqip ose e fëmijëve.

*Ata në shtëpi shkuan. vs. Ata shkuan në shtëpi.*

### Macrologjia

Kur autori përdorë më shumë fjalë se i nevojiten shprehjes.

#### POLONIUS

*Im zot, dhe zonja, me bulumtua  
 Çka dubet me qenë madhështia, çka detyra është,  
 Pse dita është ditë, nata natë, dhe koba është kobë,  
 Nuk do të ishte gjë tjetër veçse me humbë ditën, natën, dhe kobën;  
 Prandaj, [prejse] shkurtsia është shpirti i urtisë,  
 Dhe lodhja gjymtyrët dhe jashtësinë shoqnon,  
 Un do t'i bie shkurt. Djali juaj fisnik është i çmendun:  
 Çmendunë e quaj un atë, sepse me përkufizua çmenduninë e vërtetë,  
 Çka është ajo por me qenë kurgjë tjetër përveçse i çmendun?*

-- Shekspiri, Hamleti

### Pleonazmi

Gramatika jep fjalë të mjaftueshme me shprehë një mendim. Retorika mund të ndërhyjë me u sigurua që mesazhi jo vetëm përçohet, por edhe ndikon mbë audiencën. Por, ka herë kur përdorimi i tepuom e fjalëve nuk nevojsohet as prej semantikës as prej retorikës, p.sh.,

*E pashë me të dy sytë e mi.*

*E dëgjova fyemjen e tij me të dy veshët e mi.*

*E shijova akulloren me bulëzat e shijes.*

Në këto fjalë, pjesa e nënvizuome shenjon figurën (vesin) e pleonazmës; ato fjalë nuk nevojiten me përçua kumtin. Por, pleonazmi mund të përdoret edhe për theksim, çka e kthen përdorimin e saj në virtyt, p.sh.,

Në gjuhën bisedimore: *Dimni vojti e shkoi. (vojti = shkoi)*

Në Epikën Shqiptare: *Kanë nisë kangën e po këndojnë.*

*Kanë shtrua pijen e po pinë.*

*Kanë nisë kuvendin e po kuvendojnë.*

### Solecizmi

Ndërsa barbarizmat mund të shihen si keqpërdorime fjalësh të huaja dhe prandaj ato lidhen me kuptimin (semantikën), solecizmi lidhet me keqpërdorimet gramatikore. Në gjuhën shqipe ka disa përdorime të gabuome përemënash, por përdorimi i negatives së dyfishtë nuk është gjithmonë i gabuom.

*Mua (un) dhe ti do të shkojmë në librarí.*

*Ky është libri tënd. Kjo është fletorja tënde.*

*Ky është libri yt (jot, juaj). Ky libër është ytí (joti, juaji).*

*Kjo është fletorja yte (jote, juaj). Kjo fletore është ytja (jotja, juaja).*

*Nuk dëgjova kurrjã (= dëgjova diçka) vs. Nuk dëgjova gjã.*

*Nuk erdhi kurrkush (= erdhi dikush). vs. Nuk erdhi kush.*

Disa mund të përdorin ‘libri yt’, por kjo nuk përkon me ‘fletorja yte’. Po ashtu, krahaso ‘djali yt’ dhe ‘vajza yte’ dhe ‘ky djalë është i yti; kjo vajzë është e ytja’.

### Soraizmi

Kjo figurë shenjon përziemjen e gjuhëve të ndryshme ose prej respektit për gjuhën e huaj që i përziehet gjuhës vendase, ose sepse autorit i mungon njohja e gjuhës. Tipikisht, këtu dobisohen fjalë a shprehje të huaja, kur nuk është nevoja, dhe kuptimi i huazimeve nuk shpjegohet.

*Ceteris paribus<sup>1</sup> Ligji i Lekëve bazohet në parimin primus inter pares<sup>2</sup>.*

Në këtë fjalë, pjesa e nënvizueme mund të përdoret në shqip, por në qoftë se ato lehen në latinisht me tregua lidhjen me logjikën dhe ligjin e lashtë, ato duhen shpjegua.

Soraizmi mund të përdoret komikisht, p.sh.,

*Ata nuk ishin në dashni; lidhja e tyre ishte quid pro quo.*

### Tautologjia

grc. ταῦτος tautos ‘e njëjta’ + λόγος logos ‘fjalë, idé

Tautologjia njihet edhe në fusha të tjera, por në gjuhë ajo përkufizohet si përsëritja e panevojte e të njëjtës idé duke përdorë sinonime ose shprehje me kuptim të përafërt.

*dhuratë falas*

*akull i ngrimë*

*mã shum e mã shum*

*mendim personal*

*Ishte në proksimitet të afërt.*

*Jeta është çka është.*

*Përsëriteni edhe një herë.*

*Përsëriteni prapë.*

*Kthehuni prapa.*

<sup>1</sup> ceteris paribus – gjithëcka tjetër e njëjtë (lat. paribus > turq. barabir > shqip > barabar)

<sup>2</sup> primus inter pares – i parë ndër të njëjtë

